



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



KUVENDI KOMUNAL I OBILIQIT
SKUPŠTINA OPŠTINE OBILIĆ - MUNICIPAL ASSAMBLY OF OBILIQ

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2 pika d të Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare nr.28/15 qershor 2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2026 mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË OBILIQIT
PËR VITIN 2026

I

APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

II

Kuvendi i Komunës së Obiliqit planifikon të mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

III

Aktet Komunale dhe propozimet të cilat planifikohen të shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit të Komunës në vitin 2026 janë si në vijim:

Muaji / Seanca	Pikat e rendit te ditës	Shënime tjera
JANAR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Raporti i punës së KK për vitin 2025 2. Raporti financiar i shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025 3. Raporti i performancës së Komunës për vitin 2024 4. Plotësim ndryshimi i rregullorës 02/2024 për Tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 5. Miratimi për debat publik i draft-rregullorës – Kodi i etikës në Komunën e Obiliqit 6. Plotësimi i Komitetit për Komunitete me anëtarë të rinj 7. Formimi i komisionit komunal të aksionarëve në kompaninë KRM “Pastrimi” - Shqyrtimi i kërkesave	
SHKURT 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK - Mbledhja solemne	1. Plani i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2026. 2. Raporti vjetor i punës nga NPL- “Kastriotit” SH.A - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	17.02.2026 Mbledhje Solemne për nder të Shpalljes së Pavarësisë së shtetit të Kosovës.
MARS 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK - Mbledhja solemne	1. Bartja e mjeteve nga THV nga viti 2025 në vitin 2026. 2. Plani vjetor i Punës për auditim të mbrendshëm - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	05.03.2026 Mbledhje Solemne Me rastin e shënimit të 28 vjetorit të rënjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Epopesë së UÇK-së.
PRILL 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Shqyrtimi i Raportit financiar: Janar –Mars 2026 - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
MAJ 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

QERSHOR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK - Mbledhja solemne	1. Shqyrtimi dhe Aprovimi I Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB-it) 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 2. Rishikim i Buxhetit për vitin 2026 3. Rishikimi i plantit të zyrës së prokurimit - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	14.06.2026 Mbledhje Solemne për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit
KORRIK 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Shqyrtimi i raportit financiar Janar – Qershor 2026 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 3. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA. 4. Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2026. 5. Raport i DKA-së për përfundimin e vitit mësimor	
GUSHT 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Shqyrtimi i Raportit mbi pronat komunale. 2. Raport i DBZHR , mbi korreje –shirjet - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
SHTATOR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit komunal për vitin 2027 si dhe parashikimi për vitet 2028 dhe 2029. 2. Shqyrtimi i Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026. 3. Raport mbi fillimin e vitit të ri shkollor - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

TETOR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Raport nëntë mujor financiar I shpenzimeve për vitin 2026. 2. Raporti i performancës për vitin 2025. - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
NËNTOR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK - Mbledhja solemne	1. Raport nga DSHMS-ja për ofrim të shërbimeve 2. Raport nga DIL- mbi projektet 3. Themelimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	28.11.2026 Mbledhje Solemne për nder të ditës së Flamurit dhe Pavarësisë së Shqipërisë
DHJETOR 2026 - Mbledhja e KPF - Mbledhja e KK	1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2027. - Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

Me rekomandim të Grupit punues, mbledhjet e Kuvendit Komunal do të mbahen në javën e katërt të secilit muaj.

IV

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetencat e veta të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Obiliqit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta mbrenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne.

V

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si të pika III, e këtij Vendimi mund të ketë ndryshime dhe plotësime tjera në rend dite gjatë vitit, varësisht nga nevoja e funksionimit më të mirë të Kuvendit.


VI

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
-Kryesuesit
-Anëtarëve të KK
-MAPL
-Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Sami Ahmeti